



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 209/9 Prot

Tiranë, më 28.02/2020

VENDIM

Nr. 07, datë 28.02.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 209 Prot., datë 05.02.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me kërkesën e datës 06.01.2020, nëpërmjet adresës elektronike të koordinatorit për të drejtën e informimit: [gentian.rrodhe@akm.gov.al](mailto:gentian.rrodhe@akm.gov.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me masat që janë marrë mbi shkeljet e bëra nga DRM – Fier për periudhën 2017-2018, si edhe një kopje të materialit të raportit të auditimit me konkluzionet përkatëse.

Autoriteti Publik, nuk i ka kthyer përgjigje kërkueses, duke refuzuar në këtë mënyrë të drejtën e saj për informim, pa dhënë asnjë argument ligjor lidhur me refuzimin.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij. Në këtë kuadër, pas vlerësimit të ligjshmërisë së ankimit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me Urdhrin nr. 39, datë 18.02.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e

fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion.

Urdhri i inspektimit është dërguar nëpërmjet shërbimit postar pranë Autoritetit Publik, ku është regjistruar me nr. 875 Prot., datë 20.02.2020.

Gjatë inspektimit u administrua deklarimi i koordinatorit i cili deklaroi se: *“dokumenti i kërkuar administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, por përmbushja e kërkesës për informim duhet të realizohet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si institucioni që ka hartuar këtë dokument. Për këtë arsye, kërkesa i është përcjellë në datë 08.01.2020, koordinatorit për të drejtën e informimit të këtij autoriteti”*.

Nga sa më sipër, rezultoi se autoriteti e disponon informacionin e kërkuar dhe argumenton refuzimin e dhënies së tij me faktin se hartues i dokumentit ishte një autoritet tjetër dhe për këtë arsye kërkesa për informacion duhet të përmbushej prej tij. Në përfundim të procedurës së inspektimit, u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e koordinatorit të Autoritetit Publik.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumenti i parashtruar nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron. Bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, objekt i tij është e drejta e njohjes me çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë këndvështrim, çdo autoritet, pavarësisht nëse është prodhuesi apo thjesht e administron një informacion për shkak të veprimtarisë së tij, detyrohet në kuptim të këtij ligji të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Përderisa Autoriteti Publik deklaroi se administron raportin përfundimtar të auditimit, duhet ta kishte vënë atë në dispozicion të ankueses.

Për sa i përket pretendimit se Autoriteti Publik i ka deleguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesën për trajtim, sqarojmë se bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, arsyeja e vetme që justifikon refuzimin e informacionit duke e dërguar kërkesën tek një autoritet tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëndrimi i Autoritetit Publik përbën refuzim të kërkesës për informim.

Në lidhje me dokumentin e kërkuar, sqarojmë se bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky dokument bën pjesë në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Për rrjedhojë, bazuar në shkronjën *dh)* të dispozitës së sipërcituar, në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo Autoritet

Publik, këto të fundit përgatitin në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet “mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit”.

Përsa më sipër evidentohet qartë detyrimi, jo vetëm për të dhënë dokumentin e kërkuar, por për ta bërë atë publik në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, “Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përbën shkelje administrative”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. \_\_\_\_\_ ndaj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 209 Prot., datë 05.02.2020 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me masat që janë marrë mbi shkeljet e bëra nga

DRM – Fier për periudhën 2017-2018, si edhe një kopje të materialit të raportit të auditimit me konkluzionet përkatëse, brenda datës 06.03. 2020.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 28.02.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

